



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04/IA006

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 8 shkurt 2023

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Shalës për Tejkalim të Numrit të Lejuar të Fjalëve

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Aleks Uajting

Mbrojtjes së Pjetër Shalës:

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave:

Sajmon Loz

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹ duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) ka marrë apelin e dorëzuar më 6 shkurt 2023 nga Z. Pjetër Shala (përkatësisht, “Apeli” dhe “Shala”),² kundër “Versionit të Redaktuar Publik të Versionit të Korrigjuar të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala” (“Vendimi i Kundërshtuar”)³, në të cilin Shala kërkon ndër të tjera, një tejkalim me deri në 2.030 fjalë të numrit të lejuar të fjalëve të Apelit (“Kërkesa”).⁴

1. Shala kërkon tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve të Apelit në poshtëshënimin e parë të vetë Apelit. Ai argumenton se ekzistojnë arsye të vlefshme për ndryshimin e kërkuar për shkak të seriozitetit dhe kompleksitetit të çështjeve në diskutim.⁵

2. Paneli vëren se neni 46(2) i Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”)⁶ përcakton se apelet e ndërmjetme nuk duhet të jenë më shumë se 6.000 fjalë. Gjithashtu, neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës përcakton se në rrethana të posaçme, një pjesëmarrës mund t’i kërkojë leje Panelit, brenda një afati të mjaftueshëm paraprak, një tejkalim të numrit të lejuar të fjalëve, duke dhënë arsye të vlefshme që përbëjnë rrethana të posaçme.

¹ IA006/F00001, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 26 janar 2023.

² IA006/F00002, Apel i Mbrojtjes kundër “Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala”, 6 shkurt 2023 (“Apeli”).

³ F00364/COR/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 26 janar 2023, (versioni konfidencial u dorëzua më 6 dhjetor 2022) (“Vendimi i Kundërshtuar”).

⁴ Apeli, poshtëshënimi 1.

⁵ Apeli, poshtëshënimi 1.

⁶ KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019.

3. Sa i përket dorëzimit brenda afatit të Kërkesës, Paneli vëren se ajo nuk është dorëzuar përpara Apelit, por në vetë Apel. Shala jo vetëm që nuk bën parashtrime për të justifikuar vonesën e Kërkesës, por e ka vendosur Kërkesën në një poshtëshënim në Apel. Siç përcaktohet në Udhëzuesin e Punës, dhe në mungesë të një vendimi të Panelit të Apelit për të kundërtën, Shala mund dhe duhej të kërkonte një ndryshim të numrit të lejuar të fjalëve të Apelit brenda një afati të mjaftueshëm paraprak.⁷ Rrjedhimisht Paneli mendon se Kërkesa nuk është bërë në kohën e duhur.

4. Për më tepër, Shala nuk sjell argumente për parashtrimin e tij se ekzistojnë arsye të vlefshme për të miratuar shtimin e kërkuar të numrit të lejuar të fjalëve, i cili arrin në një të tretën e numrit të lejuar të fjalëve. Megjithëse i referohet në mënyrë të përgjithshme “seriozitetit dhe kompleksitetit e çështjeve në diskutim”, ai nuk shpjegon se si, në rastin konkret, ekzistojnë rrethana të posaçme që përlligjin një parashtrim të protokolluar kaq të gjatë.⁸ Në këtë aspekt, Paneli rikujton se cilësia dhe efektshmëria e apeleve nuk varen nga gjatësia, por nga qartësia dhe logjika e tyre, dhe si rezultat, apelet e stërgjata nuk i shërbejnë synimit për një administrim të efektshëm të drejtësisë.⁹

5. Në këto rrethana, Paneli i Apelit e gjykon të përshtatshme të heqë në tërësi Apelin si të dorëzuar në mënyrë të pavlefshme, dhe t’i japë mundësinë Shalës ta dorëzojë përsëri atë duke respektuar kufirin e përcaktuar të lejuar prej jo më shumë se 6.000 fjalë.¹⁰

⁷ Shih p.sh. KSC-CA-2022-01, F00063, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve në Dosjet Kundërpërgjigjëse, 12 tetor 2022 (“Vendimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve”), para. 3.

⁸ Vendimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 6-7.

⁹ Vendimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 6.

¹⁰ Shih Vendimin e Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 7.

6. Së fundi, Paneli rikujton se në bazë të nenit 36(2) të Udhëzuesit të Punës, vendimet mbi mocionet për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të merren pa u dhënë palëve mundësinë të dëgjohen.¹¹ Duke pasur parasysh rëndësinë e garantimit të procedurave të shpejta në apel, dhe meqenëse palëve nuk do t'u shkaktohet asnjë dëm, Paneli mendon se është në interes të drejtësisë që vendimi për Kërkesën të merret menjëherë.¹²

7. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

E RRËZON Kërkesën;

E HEQ Apelin; dhe

URDHËRON Shalën të paraqesë përsëri Apelin e tij në përputhje me numrin e lejuar të fjalëve prej 6.000 fjalësh brenda së hënës, 13 shkurt 2023.

/nënshkrim/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E mërkurë, 8 shkurt 2023

Hagë, Holandë

¹¹ Vendimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 8.

¹² Vendimi i Apelit në çështjen *Gucati dhe Haradinaj* lidhur me Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 8.